

Mësim në gjuhën e vendit të originës në rrethin e Olpe



albanisch

Të dashur prindër,

prej shumë vitesh në rrethin e Olpe ofrohet mësim në gjuhën e vendit të origjinës por megjithatë një gjë e tillë nuk dihet kudo. Ne dëshirojmë t'ju informojmë juve me anë e kësaj broshure dhe t'u përgjigjemi disa nga pyetjeve tuaja. Nëse keni pyetje të tjera ne jemi me kënaqësi në çdo kohë në dispozicionin tuaj.

*Qendra juaj komunale e integritit
Rrethi Olpe*

„Një gjuhë e dytë mësohet vetëm atëherë, pasi të jenë mësuar të paktën bazat e një gjuhe të parë.“

(Rothweiler 2007)

Çfarë është mësimi në gjuhën e vendit të origjinës?

Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës (shkurt: MGJVO) është një ofertë e landit të NRW për nxënës dhe nxënës të klasave 1 deri 10, të cilët rriten me dy gjuhë, me gjermanisht dhe një gjuhë tjetër. Shtetësia është e parëndësishme. Mësimi realizohet bazuar në specifikimet e landit dhe ndodhet në vëzhgimin e tij të shkollave.

Përse është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë me prejardhje emigrantësh të mësojnë gjuhën e vendit të tyre të origjinës?

Për fëmijët dhe të rinjtë të cilët nuk disponojnë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane mësimi i gjuhës gjermane qëndron në vendin e partë të objektivave mësimore. Kërkimet shkencore vërtetojnë që kujdesi për gjuhën e vendit të origjinës jep një kontribut të jashtëzakonshëm në mësimin e gjuhës gjermane. Edhe praktika shkollore tregon shpesh që nxënëset dhe nxënësit me njohuri të mjaftueshme në përputhje me moshën e tyre të gjuhës së vendit të origjinës, të cilët futen si të ashtuquajtur prurje anësore në ecurinë e tyre shkollore në një shkollë Gjermane, e mësojnë Gjermanishten shumë më lehtë se moshatarët e tyre të cilët janë rritur në Gjermani pa pasur një nxitje.



Gjuhët e sjella të vendeve të tyre të origjinës dhe kultura e vendeve të origjinës janë pjesë e identitetit të këtyre fëmijëve ose të rinjve; ato janë tepër të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre.

Përveç të tjerave, mësimi i disa gjuhëve është një pasuri kulturore dhe në kohët e sotme edhe një kusht i përgjithshëm arsimor.

Kur dhe ku zhvillohet mësimi në gjuhën e vendit të origjinës?

Mësimi zhvillohet në shumicën e rasteve pasdite dhe përfshin normalisht 3 deri në 5 orë në javë. Shkollat ju informojnë juve bazuar në kërkesat tuaja se ku është organizuar mësimi në gjuhën e vendit të origjinës.

Në cilat gjuhë ofrohet MGJVO?

Aktualisht në rrethin Olpe ekzistojnë oferta të MGJVO në shqip, greqisht, italisht, polonisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht.

Por oferta mund të rritet nëse ekziston nevoja dhe nëse grumbullohen mjaftueshëm nxënës, që do të thotë që mund të regjistroheni dhe në këtë mënyrë do të vendoseni në një listë pritje.



Kush e jep mësimin në gjuhën e vendit të origjinës?

Trupa mësimore janë persona që gjuhën që japin mësim e kanë gjuhën e nënës dhe të cilët posedojnë aftësitë përkatëse për mësimdhënie në fushën e mësimdhënies në gjuhën e vendit të origjinës, bazuar në ligjet gjermane. Ato janë punonjës të landit.

A marrin fëmijët një notë ose një certifikatë?

Trupa mësimore lëshon një vërtetim në lidhje me pjesëmarrjen në mësim në gjuhën e vendit të origjinës. Nota e marrë vendoset në dëftesë në rubrikën shënime.

Nxënëset dhe nxënësit të cilët kanë marrë pjesë rregullisht në mësimin në gjuhën e vendit të origjinës, në përfundim të shkollimit të tyre në shkollën sekondare I japin një provim gjuhe. Shkalla e vështirësisë së provimit orientohet sipas llojit të shkollimit të kryer nga nxënësi. Rezultati i provimit shënohet në dëftesën përfundimtare. Nota e provimit vendoset në rubrikën „Performanca“.

Një performancë të paktën e mirë në provimin e gjuhës mund të barazojë një performancë të dobët në një gjuhë të huaj.

A është mësimi në gjuhën e vendit të origjinës kusht për të kaluar klasën?

Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës nuk ka të njëjtën rëndësi për kalimin ose përfundimin e klasës siç ka mësimi i rregullt. Por performancat pozitive merren parasysh në rastin e ngeljes në klasë, në kuadrin e gjykimit pedagogjik në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm të një nxënëseje ose një nxënësi.

A mund të vendoset gjuha e vendit të origjinës si lëndë mësimore në vendin e një gjuhe të huaj?

Në disa raste në shkollat e shkallës sekondare I gjuha e vendit të origjinës mund të ofrohet në vend të një gjuhe të huaj të dytë ose të tretë.

Në këtë rast ajo në çdo aspekt ka të njëjtën vlerë siç ka mësimi i një gjuhe të huaj. Në këto raste mund të formohen edhe grupe të përbashkëta mësimore për disa shkolla të të gjitha formave shkollore të shkallës sekondare I. Këto mund të përfshijnë përkatësisht dy shkallë brezash (klasat 7./8. dhe 9./10.). Përveç të tjerave, në gjimnaz, gjuha e vendit të origjinës mund të vendoset në vendin e gjuhës së parë të huaj. Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës në vend të një gjuhe të huaj në shkallën e lartë të gjimnazit mund të vazhdojë deri në maturë.

Si mund të marr pjesë në MGJVO?

Për të marrë pjesë nevojitet regjistrimi. Regjistrimi është me dëshirë, por detyron pjesëmarrjen e rregullt për një vit shkollor. Nxënëset dhe nxënësit mund ti marrin formularët e regjistrimit në sekretarinë e shkollës tyre.

Informacione më të detajuara merrni këtu:

Kreis Olpe
Westfälische Str. 75
57462 Olpe

Partneri i kontaktit:
Pilar Calero Westermeier
Kommunales Integrationszentrum
Tel.: 02761 / 81 609
E-Mail: p.calero-westermeier@kreis-olpe.de

Barbara Wolf
Schulamts Kreis Olpe
Tel.: 02761 / 81 596
E-Mail: b.wolf@kreis-olpe.de



nxitur nga:

Ministerium für Arbeit,
Integration und Soziales
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für
Schule und Weiterbildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Informacione të tjera gjeni në dekretin “Unterricht für Schülerinnen und Schüler mit Zuwanderungsgeschichte, insbesondere im Bereich der Sprachen” („Mësimi për nxënëset dhe nxënësin me histori emigrimi, sidomos në sektorin e gjuhëve“) të Ministrisë për Shkollën dhe Arsimin i datës 21.12.2009 (BASS 13 – 63 Nr. 3).